

E DIELA E MYRREPRURSEVE

THIRRTORET, T. II

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe tri të Myrrëprurseve, dyke përsëritur të parën:

PAS IKOS TU EFRATHA, T. II

Kush na e rrugullis, nga der' e varrit gurin? Po Engjëlli i ndriçim, me buj' u thirri Grave: U-ngjall dhe fluturoj në qjell.

Lote dhe myrra plot, në varr i prunë Gratë; po Engjëlli pyeste: Në varrin ç' e kërçoni, të gjallin me të vdekurit?

Shkoni në Galile, dishepuj si qëmoti, atje do ta shikoni, dhe passi ta dëgjoni, zbatoni porrosit' e tij.

LAVDI. Trupi s'ishte në varr, dhe Gratë po vajtonin: Kush na e vodhi Krishtin? Mos mbani zi në dasmën! U-ngjall dhe fluturoj në qjell.

TANI. Ka shkuar errësir' e Ligjës . . . (Shiko Kremtoren, f. 80)

PASVARGJET, T. II

Ngjallja jote o Shpëtimtar Jesu, ndriti tërë botën dhe tërë krijesën, dhe e ndolli prapë njerin' e mjerë, Zot i Forcave lavdi më ty.

Pastaj Vargëzimet e Pashkës, Lavdia e Pashkës, dhe Përleshoret e Myrrëprurseve. (Shiko në Hyrjen e Meshës). Në Shërbesën e Mëngjezit, Ndënjësoret, Bekimtoret, Dëgjimi, dhe Shkallesat e Tingëllit II si të Dielat e zakonta, pastaj:

SHKURTORJA, T. II.

Passi u the Myrrëprurseve Gëzohuni, dhe e pushove vajtimin e stërgjyshes Eva, me Ngjalljen tënde o Krisht o Perëndi, i urdhërove Apostujtë të lëçitin: Shpëtimtari u-ngrit nga varri.

SHTEPIA

Myrrëprurëset, kur shkonin në varrin tënt, pyesnin vetë veten: Cili do na e rrugullizë gurin nga varri? Edhe kur ngritnë sytë, panë Engjëllin, i cili u tha: Mos kini frikë, po shkoni dhe lajmërojini dishepujtë: Shpëtimtari u-ngrit nga varri.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Tretë pas Pashkës, kremtojmë ditën e Grave të Shenjta Myrrëprurëse.

Gjithë sot, kujtojmë Josefin e Arimathisë, i cili ishte dishepull i fshehur.

Gjithë sot, kujtojmë edhe Nikodemin, dishepullin e nates.

Me nërmjetimet e Myrrëprurseve të Shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Pastaj Zbritësoret e Pashkës, Ungjilli Mëngjezor IV (shiko Kremtoren, f. 143-4), dhe Madhështimet e Pashkës.

DERGIMESORET, T. II.

SARKI IPNOSAS

Si fjete si njeri me trup, o Mbreti yne Zoti Krisht, u-ngjalle të tretën ditë, dhe ngrite gjyshin Shën Adam, dhe e dërmovë vdekjen krejt. Pashkë burim i jetës, shpëtim i besnikëve. (1 herë)

Pastaj dy herë kjo e Myrrëprurseve:

PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Dëgjoni Myrrëprurëse, një lajmë ngazëllimi:

Krishti e shkeli Ferrin sot, dhe na shpëtoj nga vdekja, pra rentni thojuni miqve, Zoti u-ngrit nga varri, edhe ju pret në Galile, dhe atje do ta hasni si gjithënjë, për të nisur punën edhe lëçitjen, në botën midis kombeve, gjer në mbarim të jetës. (2 herë)

LAVDERIMET, T. II.

Këndohen tetë, domethënë katër të Tingëllit edhe katër të Pashkës së Madhe:

Çdo frymë dhe çdo krijesë, ty të lavdëron o Zot, se me kryqësimin tënt e shove vdekjen krejt, dhe u çpalle popujve, Ngjalljen e gjithë njerësve, o Zot i mëshirave.

Tregoni o të pabesë, si e qysh ata qe e ruanin, e humpnë natën Jesunë, dhe përse vallë guri, nuk e ruajti dot gurin jetësor? A të varrosurin kthenani, a si të ngjallur adhurojeni; thoni pra tok me ne: O Shpëtimtar i zëmërdhëmpshur, o Zot lavdi më ty.

Gezohuni dhe ngazëllohuni o popuj, Engjëlli i qiellit që po rrinte mi varrin tënt, ay na lajmëroj edhe ay na tha: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, Shpëtimtar i botës, dhe e mbushi gjithësinë me erë lulësh, gëzohuni o popuj dhe ngazëllohuni.

Engjëlli i tha Gëzohu, Shën Marisë Zonjës Hyjli-ndëse, dhe ardhjen tënde botës ia lajmëroj; Engjëlli prapë zbriti edhe gurin e varrit tënt, e rrugullizi për Ngjalljen e ndriçime. Kështu pra ky na çeli, na lëçiti lajmë ngazëllimi, ay në vënt të vdekjes, të gjallë Shpëtimtarin na e proklamoi, thërresim pra me zë: Mirëbërës i krijesës o Zot lavdi më ty.

Pastaj Vargëzimet e Pashkës, Lavdia e Pashkës, dhe Taniu

e Ditës më Tingëllin II: "Kur me myrrat u-afruan. . ." (shiko Kremtoren, f. 136). Pastaj nis Mesha si ditën e Shën Thomajt. Në Hyrjen këndohen:

PERLESHORET E MYRREPRURSEVE, T. II

Zbrite në vdekje dhe në varr për ne, ti o jet' e pavdekshime, Ferrin të vdekur e shtrive ti, kur shkrepëtime si Perëndi; edhe kur i ngrite nga fundet e dheut që të gjithë të vdekurit, Forcat Engjëllore lart në qjell thërrisnin me zë të math: Jetedhënës Jesu, Zoti ynë lavdi më ty.

LAVDI. Bujari Shën Josef, passi e zbriti trupin tënt, prej Kryqit të Çëmuar, e vuri në savan, të bardhë midis myshkeve, edhe me vaje e vëndosi në varr të ri.

TANI. Grave me myrra dhe me vaj, përpara varrit u qëndroj, një Engjëll që u thoshte, se myrrat u përkasin vetëm të vdekurve, po Krishti u-ngrit si Perëndi, prej vedkjës aspak s' u-nga. U-ngjalle o Zoti Krisht, dhe botës i fale mëshirë dhe shpëtim.

Hyrtoja dhe Shkurtoja e Pashkës, Hymni Trishenjtor, dhe pastaj:

APOSTULLI

Zoti është forca ime dhe mprojtja ime.

Zoti më mundoj dhe më arësoj.

Këndimi prej Akteve të Apostujve.

Më ato ditë, si u-shtuan dishepujtë, u-bë një qarje prej Helenistëve kundër Hebrenjve, se lihëshin mënjanë të vejat e tyre në shërbimin e përdiçim. Edhe të Dymbëdhjetët e ftuan shumicën e dishepujve, dhe u thanë:

“Nuk është e pëlqyer që ne ta lemë fjalën e Perëndisë, dhe të shërbejmë në tryezat. Zgjithni pra, o vëllezër, shtatë veta prej jush, të frymësuar prej Shpirtit të Shenjtë, të cilët të kenë rekumandata të mira, dhe të cilët t’i vëndosim për këtë detyrë, edhe ne të shikojmë shërbesën e faljes dhe të predikimit.” Edhe ky proponim u pëlqye prej të gjithëve me një zë; edhe zgjithnë Stefanin, një burrë plot me besë dhe me Shpirt të Shenjtë, dhe Filipin, dhe Prokorin, dhe Nikanorin, dhe Timonin, dhe Parmenanë, dhe Nikollin, një proslit Antiokas, të cilët i nxuarnë përpara Apostujve; edhe këta, pasi u falnë, u vunë duartë mi kokën. Edhe fjala e Perëndisë përhapej, edhe numri i dishepujve rritej shumë; edhe një shumicë e madhe prej Priftërinjve e dëgjonin besën.

UNJILLI PAS MARKUT

Më atë kohë, Josefi nga Arimathia, i cili ishte dishepull i Jesujt, po i fshehur nga frika e Judenjve, iu lut Pillatit që ta ngrente trupin e Jesujt. Edhe Pillati i dha leje. Ardhi pra, dhe e ngriti trupin e Jesujt. Ardhi edhe Nikodemi, ay që i kishte vajtur Jesujt një natë më parë, edhe pruri smirnë dhe allojë të përzier nja një qint litra. Pra, e muarnë trupin e Jesujt, edhe e pështuallnë me pëlhura dhe me aroma, siç e kanë zakon të varrosin Judenjtë. Edhe në vëndin ku u-kryqësua ishte një kopsht, edhe në kopshtin ishte një varr i ri, në të cilin nuk ishte varrosur tjetër njeri. Atje, pra, e vëndosnë Jesunë nga shkaku i së Premtes së Judenjve, se varri ishte afër.

Edhe pasi shkoj e Shtuna, Maria Madalena dhe Maria e Jakobit edhe Salloma kishin blerë arroma që të vinin edhe ta lyenin trupin e Jesujt. Edhe shumë

menatë, më të lindur dielli, ditën e parë të javës, po venin në varrin, dhe po thoshin me veten e tyre: “Kush do na e rrugullizë gurin prej derës së varrit?” Edhe kur ngritnë sytë, panë se guri ishte rrugullizur edhe guri ishte fort i math. Edhe kur hynë brënda në varrin, panë një djalosh, të veshur me një stoli të bardhë, që rrinte më të djathtë, edhe u-çuditnë. Po ay u tha: “Mos u-çuditni. Kerkoni Jesunë e kryqësuar prej Nazaretit; u-ngjall, nuk është këtu; ja vëndi, ku e kishin vënë. Po ecëni, dhe u thoni dishepujve të tij dhe Pjetrit që shkoj edhe ju pret në Galile; atje do ta shikoni, sikundër ju ka thënë.” Dhe ato duallnë me vrap, edhe iknë nga varri; edhe ishin të trëmbura dhe të habitura, dhe nuk i thanë njeriu gjësendi, se kishin frikë.

Në “Veçan Tërëshenjtën,” këndohet Zbritësorja IX me Tingëllin Tërthor të Parë:

MADHESHTIMI I MESHES

O ANGELLOS EVOA

Një Engjëll i thërriste, hirplotes pa pushuar: Gëzohu Virgjëreshë, dhe prapë të them Gëzohu, se Biri yt nga varri, u-ngjall të tretën ditë.

Ndriçohu, ndriçohu, qytet i ri Jerusalem, se lavdia e Zotit, përmi ty ka lindur sot. Valle këce, dhe gëzohu Sion, ti o Mari, Nën’ e Perëndisë, dëfre për Ngjalljen e Birit tënt.

KUNGATORJA

Trupin e Krishtit e kungoni, burimin e pavdekur e ngjëroni. Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të “Pamë Dritën,” këndohet Përlëshorja e Pashkës:

KHRISTOS ANESTI

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen
dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të
re. **(3 herë)**

Pas Urates Përpara Tribunës këndohet:

Emri i Zotit qoftë i bekuar që tani dhe gjer më
jetë. **(3 herë)**

Përlëshimi i Pashkes.